



UNIVRSITETI I PRIZRENIT
“UKSHIN HOTI”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. “Rruga e Shkronjave” nr.1, 20000 Prizren - www.uni-prizren.com

PROGRAMI MËSIMOR							
Niveli i studimeve		Bachelor	Programi	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	Viti akademik	2021-2022	
LËNDA		Etimologji					
Viti	IV	Statusi i lëndës	Zgjedhore	Kodi		ECTS kredi	4
Semestri	7						
Javët mësimore		15		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtrime
						2	1
Metodologjia e mësimit dhe përshkrimi i lëndës		<p>Lënda e Etimologji do të zhvillohet me 2 orë ligjërata dhe 1 orë ushtrime në javë. Përveç metodës frontale, do të përdoren edhe metodat ndërvepruese (interaktive), si ajo e bashkëbisedimit, e komentimit, e vlerësimit, e argumentimit, e analizës, e sintezës etj. Studentët do të udhëzohen të lexojnë literaturë gjuhësore e shkencore dhe në orët mësimore do të debatohet për to. Në fillim të semestrit atyre u jepen tema për punim seminarik dhe deri në fund të semestrit duhet të dorëzojnë atë. Disa nga këto punime seminarike studentët do t'i prezantojnë me Power Point në orët e ushtrimeve.</p>					
Mësimdhënës		Prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj		e-mail	xhafer.beqiraj@uni-prizren.com		
				Tel.	+383 44 950 - 369		
Asistent							

Qëllimi studimor i lëndës	Rezultatet e pritura dhe përfitimet e studentit	
<p>Lënda ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të marrin njohuri për strukturën e gjuhës në planin diakronik, më saktësisht për zhvillimet historike të shqipes. Njohja e ligjeve gramatikore të shqipes, të cilat mundësojnë rindërtimin dhe ndriçimin e shumë çështjeve që kanë të bëjnë me Etimologjinë ose Gramatikën historike të shqipes në përgjithësi, të cilat përmes metodës historiko-krahasimtare të jashtme (krahasimit të shqipes me gjuhët e vjetra i.e., të cilat kanë një histori shkrimore mjaft të hershme) dhe asaj të brendshme (krahasimit të shqipes aktuale me fillimet e shkrimit të shqipes, d.m.th. me shqipen e shekullit 16 dhe me te folmen e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë) japin rezultatet e kërkuara. - Nxitja dhe motivimi për një angazhim sa më gjithëpërfshirës dhe për krijimin e gjykimit personal. - Aftësimi për mendime, gjykime, teza e kundërteza rreth etimologjisë së pjesëve të ligjëratës dhe veçorive të tyre gramatikore etj. 	<p>Studentët nga kjo lëndë mësimore do të kenë përfitime teorike dhe praktike. Pikësynimi kryesor i lëndës është të kuptojnë drejt Etimologjinë shqiptare, ndihmesën e filologëve të huaj dhe shqiptarë për studimin e gjuhës shqipe.</p> <p>Përvetësimi i njohurive dhe shkathtësive bazë për zotërimin e gjendjes së strukturës së shqipes në një zhvillim sa më të largët historik, por edhe në nivelin e sotshëm, gjithmonë duke u bazuar në rezultatet e arritura shkencore në këtë drejtim.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Formimi i shprehive për punë të pavarur interpretuese, krijuese dhe shprehëse në thellimin e këtyre njohurive aq të errëta për strukturën e shqipes. - Bazuar në tezat e kundërtezat e studuesve të shumtë që do t'i shqyrtojmë gjatë kursit, të aftësohet të gjykojë edhe vetë në argumentimin ose joargumentimin e këtyre tezave, - të japë edhe vetë mendimet e veta për çështje diakronike, të cilat janë ende të diskutueshme. - të formojë shprehi e shkathtësi për motivim të mëtejshëm në ndriçimin e prejardhjes së fjalëve, çështjeve diakronike për strukturën e shqipes etj. 	
Metodologjia për realizimin e temave mësimore:		
Ligjërata, ushtrime, punime seminarike, prezantime, punëtori, punë kërkimore e hulumtuese në literaturë e tekste të përzgjedhura, detyra, ushtrime me shkrim e me gojë, diskutime, debate, konsultime etj.		
Kushtet për realizimin e temës mësimore:		
Klasë, tabelë (e zezë ose e bardhë), shumës, marker, materiale të fotokopjuara, libra profesionale, kompjuter, projektor etj.		
Mënyra e vlerësimit të studentit (në %)		
	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
	Vijimi – 05%	prej 0 deri më 50 pikë - nota 5
	Punim seminarik – 10%	nga 51-60 pikë - nota 6
	Detyra – 5%	nga 61-70 pikë - nota 7
	Testi i parë – 15%	nga 71-80 pikë - nota 8
	Testi i dytë – 15%	nga 81-90 pikë - nota 9
	Provimi përfundimtar – 50%	nga 91-100 pikë - nota 10

Obligimet e studentit:			
Ligjërata		Ushtrime	
Studentët kanë për detyrë të ndjekin rregullisht ligjëratat. Në mënyrë ndërvepruese të marrin pjesë në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe t'i kryejnë të gjitha angazhimet që i jep mësimdhënësi.		Studentët kanë për detyrë të marrin pjesë aktive në orët e ushtrimeve. Për çdo paqartësi që kanë me materien e lëndës mësimore, të konsultohen me mësimdhënësin. Gjatë semestrit të bëjnë një punim seminarik, me parapëlqim që ai të prezantohet me Power Point në klasë, të hyjnë në dy paraprovimet dhe së fundmi t'i nënshtrohen provimit përfundimtar.	
Ngarkesa e studentit për lëndën:			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	15 javë	30
Ushtrime teorike e analiza	1	10 javë	10
Koha e studimit në bibliotekë	1	10 javë	10
Projekte, prezantime, detyra	1	10 javë	10
Përgatitja për teste	1	10 javë	10
Përgatitja e përgjithshme për provimin përfundimtar	3	10 javë	30
Vërejtje: Po qe se vlefata e 1 ECTS kredie është 25 orë, atëherë rezulton se për ta përgatitur provimin e lëndës së <i>Gjuhës shqipe I</i> , studentit i duhen 100 orë pune. Kjo del edhe kur 100 orë pjesëtohen me 25, rezulton se lënda ka vlefatë prej 4 kredish.		Ngarkesa totale:	100

Java	Ligjërata	Ushtrime
1.	Tema Njoftime të përgjithshme për format dhe metodat e punës, qëllimin e lëndës, mënyrën e vlerësimit, udhëzime për punë të pavarur dhe për literaturën e domosdoshme e shtesë. Objekti i etimologjisë.	Tema Diskutim për fjalët dhe historinë e tyre.
	Orët	Orët
	2	1
2.	Struktura e fjalës dhe rëndësia e saj për studimet etimologjike (aspekti sinkronik).	Ushtrime për strukturën e fjalës.
	Orët	Orët
	2	1
3.	Morfemat dhe llojet e saj; morfema rrënjore, fjalëformat dhe tema e fjalës.	Ushtrime dhe analiza për morfemat dhe temën e fjalës.
	Orët	Orët
	2	1

4.	Morfemat ndajshesore: parashtesa, prapashtesa, mbaresa dhe nyja.	2	Ushtrime për strukturën e fjalës. Analizë strukturore e saj.	1
5.	Tipat e fjalëformimit: - prejardhja, - përbërja, - përngjitja, - konversioni, - nyjëzimi.	2	Ushtrime dhe analiza të tipave të fjalëformimit.	1
6.	Aspekti historik i prejardhjes së fjalës dhe studimet e derisotme etimologjike.	2	Testi i parë (I)	2
7.	Metoda historiko-krahasimtare e studimeve në fushë të etimologjisë.	2	Ushtrime për metodat.	1
8.	Rëndësia e rrafshi fonetik në hulumtimet etimologjike (zhvillimet fonetike).	2	Ushtrime për rrafshin fonetik në hulumtimet etimologjike (zhvillimet fonetike).	1
9.	Rëndësia e rrafshit morfologjik në hulumtimet etimologjike.	2	Ushtrime për rrafshin morfologjik në hulumtimet etimologjike. Përsëritje.	1
10.	Rëndësia e rrafshit semantik në hulumtimet etimologjike.	2	Ushtrime për rëndësinë e rrafshit semantik në hulumtimet etimologjike.	1
11.	Fjalët e trashëguara të shqipes nga nëna e saj (fjalët me burim i.e.).	2	Ushtrime për fjalët e trashëguara. Përsëritje.	1
12.	Fjalët e huazuara të shqipes nga latinishtja, greqishtja, sllavishtja.	2	Ushtrime për huazimet.	1
13.	Fjalët e huazuara të shqipes nga turqishtja, dhe ngjashmëritë me rumanishten.	2	Përsëritje për huazimet dhe kohën kur janë huazuar ato.	1
14.	Kontributi i etimologëve të huaj dhe vendës, dhe qëndrimi i tyre për fjalët e trashëguara dhe të huazuara të shqipes.	2	Përsëritje e përgjithshme e kësaj pjese.	1

15.	Përmbledhje (përsëritje) e përgjithshme e lëndës në fund të semestrit.	2	Testi i dytë (II)	1
LITERATURA				
<ol style="list-style-type: none"> 1. Çabej, E., <i>Studime etimologjike në fushë të shqipes I</i>, Tiranë, 1982. 2. Shaban, D., <i>Morfologjia historike e gjuhës shqipe</i>, pjesa I dhe II, Prishtinë, 1980. 3. Besim, B., <i>Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes</i>, Prishtinë, 1980. 4. Demiraj, Sh., <i>Gjuha shqipe dhe historia e saj</i>, Tiranë, 1996. 5. Demiraj, Sh., <i>Fonologjia historike e gjuhës shqipe</i>, Tiranë, 1996. 				
VËREJTJE				
<p>Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.</p>				
Vërejtje për studentin:				
<p>Studentët duhet t’u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor.</p> <p>Pritet që secili student të vijë me kohë.</p> <p>Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjëratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimin në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është e domosdoshme. Çdo mungesë e vazhdueshme rezulton me zbritjen e notës finale. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t’i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.</p>				